



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 04 qershor 2008, nenit 7 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 22 nëntor 2012, nenit 4,5 të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26 shtator 2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 31. 10. 2018, pas shqyrtimit të propozimit të vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM
PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

Me këtë Vendim ipen në shfrytëzim afatshkurtër subjekteve politike që kanë të themeluar degët e tyre në Komunën e Lipjanit, paluajtshmëritë-lokalet në pronësi të komunës të shënuara më poshtë, të cilat gjenden në parcelën kadastrale: P-71409044-01773-1 Zona kadastrale në Lipjan për zhvillimin e aktiviteteve të tyre politike.

Nr.	Njësia kadastrale	Adresa	Kati	Sipërfaqe m ²	Gjithsej m ²
1	O-71409044-01773-1-11-3-10 O-71409044-01773-1-11-3-11-0	Rr.Sheshi "Adem Jashari"	P+4 --	34.47 m ² 31.48 m ²	65.95 m ²
2	O-71409044-01773-1-11-3-12-0	Rr.Sheshi "Adem Jashari"	P+4	40.59 m ²	

Neni 2

Sipas nenit 1 të këtij Vendimi pronat-lokalet me Nr. rendor 1 (sipërfaqe prej 65.95 m²) dhe me Nr. rendor 2 (sipërfaqe prej 40.59 m²) ipen në shfrytëzim, afatshkurtër në afat prej 10 vitesh nëpërmjet ankandit publik të përcaktuar sipas Rregullores QRK Nr.23/2013 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Dhënia e lokaleve në shfrytëzim sipas këtij vendimi bëhet me qëllim të realizimit të interesit publik dhe rritjes së vlerës së pronës publike komunale me destinim për subjektet politike-që kanë të themeluara degët e tyre në Komunën e Lipjanit për zhvillimin e aktiviteteve të tyre politike.

Neni 4

Procedurën e ankandit publik e zbaton Komisioni Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal 15Nr.463-67906 të datës 22.12.2017, në bazë të Rregullores QRK Nr.23/2013 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Ekonomi e Zhvillim dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi fshihet pjesërisht paragrafi 1.6 lokali me sipërfaqe prej 54 m² i pikës 1 të Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës së Lipjanit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës 15Nr.464-45591 të datës 12.11.2014.

15Nr. 463-67001

Lipjan, më 01. 11. 2018

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

